



Nr. Ref. BD-221/1

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenit 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura me 27 shkurt 2025 dhe asaj me 14 mars 2025 nëpërmjet këtij vendimi aprovohet si procesverbale të mbledhjeve të Bordit të cekura më lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi sipas procedurave procesverbalet e mbledhjeve paraprake të mbajtura me 27 shkurt 2025 dhe asaj me 14 mars 2025 Dokumenti aprovohet në pajtim me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenin 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së.

Duke marrë parasysh këtë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 mars 2025.


Mënik Haxhi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-221/2

Në bazë të neneve 15.1, 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) nenet 3, 9.5 dhe 9.6 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Bordi nuk e lejon shfrytëzimin e katit të dytë të ndërtuar në mënyrë të paaautorizuar.
- II. Obligohet qiramarrësin LENI AG që ta rikthejë objektin në gjendjen e tij të mëparshme, në përputhje me karakteristikat arkitektonike të strukturës fillestare të objektit.
- III. Shfrytëzimi i hapësirës së rinovuar bëhet vetëm për aktivitetin që është i cekur në kontratës e qirasë si parking i NSh Inex Sharr Planina Brezovica të lëshuar me qira për palën LENI AG.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi sipas procedurave çështjen lidhur me qiramarrësin LENI AG për parkingun afër "Mala Brvnara" dhe kërkesat e tij që kanë të bëjnë me restaurimin e një shtëpizë druri apo barake që ndodhet në kuadër të hapësirës e cila shfrytëzohet për parking.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Në shkresën datës 04.07.2024 dhe 09.07.2024 pala ka kërkuar rrënimin e barakës së ndërtuar prej dërrasave dhe ndërrimin e saj me një tjetër, për të shfrytëzuar hapësirën për parking, si dhe nivelimin e terrenit me zhavor (pa betonim) dhe rrethimin e saj me material jo të fortë.

Agjencia i ka kthyer përgjigje palës me datë 06.08.2024 ku thuhet:

"AKP nuk jep pëlqimin për rrënimin e barakës; në hapësirat e pronës shoqërore nuk lejohet ndërtimi i ri. Eventualisht, në koordinim me Menaxhmentin e NSH Brezovica, mund të bëhet rrethimi i barakës nëse ajo paraqet ndonjë pengesë dhe pasiguri në shfrytëzimin e hapësirës që keni marrë me qira."

"Ndërsa lidhur me nivelimin e terrenit dhe përshtatjes së hapësirës për parking AKP nuk e kundërshton përderisa i përmbaheni kushteve të kontratës së qirasë dhe merrni leje parapake nga organet kompetente komunale si dhe pajtoheni që pas përfundimit të kontratës të bëhet kthimi i pronës në gjendjen e mëparshme, këto investime nuk do ju kompensohen as nga NSH dhe as nga AKP."

Çfarëdo veprimi jashtë kushteve të parapara me kontratën e qirasë do të konsiderohet joligjor dhe do të pasoj me shpërbërje të kontratës së qirasë."

Në shkresën e datës 25.09.2024 qiramarrësi ka kërkuar lejimin për restaurimin e kioskut të demoluar me të njëjtin material, duke ndërruar mbulojën e kulmit, duke ruajtur përmasat, pozicionin dhe formën ekzistuese, dhe duke e përdorur për qëllime të parkingut (për stafin kujdestar dhe mjetet e punës).

Në përgjigjen e AKP-së (datës 28.10.2024) thuhet si në vijim:

"Restaurimin e kioskut e planifikoni të bëni nga materiali, përmasa ekzistuese dhe në të njëjtin pozicion. Gjithashtu, kërkon ndërrimin e mbulojës së kulmit, që konsideroni se kulmi me përbërje të dëmshme për shëndetin. Sa i përket sigurisë së frekuentuesve dhe punëtorëve, AKP nuk e kundërshton restaurimin, përderisa i përmbaheni kushteve të kontratës së qirasë, merrni leje parapake nga organet komunale dhe"

MH



pajtoheni që pas përfundimit të kontratës të bëhet kthimi i pronës në gjendjen e mëparshme. Këto investime nuk do të kompensohen nga NSH as nga AKP."

Në shkresën e palës të datës 11.12.2024 pala ka deklaruar se realizuar punimet rreth renovimit të shtëpizës së demoluar dhe ka kërkuar që kioskën të shfrytëzoni si kafene, për të mbuluar shpenzimet, duke mundësuar edhe angazhimin e më shumë punëtorësh.

Me përgjigjen e AKP-së të datës 20.01.2025 (prot. nr. 444), qiramarrësi është njoftuar se:

"Bazuar në kontratën e qirasë, kërkesa juaj për renovim është aprovuar. Ju mund të shfrytëzoni kioskën e rinovuar, përderisa i përmbaheni kushteve të kontratës së qirasë, merrni leje paraprake nga organet kompetente komunale dhe pajtoheni që, pas përfundimit të kontratës, prona të kthehet në gjendjen e mëparshme. Investimet nuk do të kompensohen".

Duke marrë parasysh atë që u tha më lartë pas shqyrtimit të rrethanave të çështjes dhe verifikimit në terren, konstatohet se qiramarrësi LENI AG ka realizuar ndërhyrje strukturore në objektin e dhënë me qira, përkatësisht ka ndërtuar një kat shtesë mbi strukturën ekzistuese prej një (1) kati e gjysmë, duke tejkaluar përmasat dhe karakteristikat arkitektonike të objektit të mëparshëm. Kjo ndërhyrje është bërë pa autorizim dhe në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në kontratën e qirasë nenit 2.6.2 dhe dispozitat përkatëse ligjore. Bordi në pajtim me nenet 15.1, 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) nenet 3, 9.5 dhe 9.6 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 mars 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-221/3

Në bazë të nenit 15.2.1 i Ligjit nr. 04/L-034 të Agjencisë (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), bazuar në përgjegjësitë e përgjithshme të Bordit të Drejtorëve, si dhe nenin 15 dhe 16 të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, që parasheh Monitorimin dhe Raportimin për sistemin e kontrollit të brendshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Pyetësori i plotësuar vetë-vlerësues për sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2024.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Menaxhmenti për shqyrtimi dhe aprovimin e Pyetësorit Vetë-vlerësues për Sistemin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit me qëllim të raportimit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Në përputhje me Ligjin nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, të gjitha subjektet e sektorit publik (në këtë rast edhe AKP) janë të obliguara të kompletojnë pyetësorin vetë-vlerësues për sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Qëllimi i këtij pyetësori është të informojë Ministrinë e Financave, Njësinë Qendrore Harmonizuese në lidhje me aktivitetet e ndërmarra nga të gjitha subjektet e sektorit publik lidhur me funksionimin e sistemit të tyre të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, në mënyrë që ti ofroj Ministrisë së Financave të dhënat e nevojshme për përgatitjen e "Raportit Vjetor për sistemin e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike për vitin 2024" për të gjitha institucionet publike, që do t'i paraqitet më pas Qeverisë së Kosovës.

Duke u bazuar në të lartcekurat Bordi vendosi si më lartë.

Prishtinë, më 27 mars 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-221/4

Në bazë të nenit 15.1 i Ligjit nr. 04/L-034 të Agjencisë (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Miratohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) për vitet 2026 – 2028.

II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Menaxhmenti për shqyrtimi dhe aprovimin e Kornizës Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) për vitet 2026 – 2028.

Në përputhje me obligimet që dalin nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, kërkohet nga Agjencia që të përgatis dhe të dorëzoj në MFPT dokumentin e KASH-it për periudhën e ardhshme tri vjeçare. Qëllimi i përgatitjes së KASH-it është përqendrimi i planifikimit të një buxheti stabil dhe të qëndrueshëm mbi bazën e të cilit do të hartohet buxheti vjetor për vitin 2026 dhe parashikimet 2027-2028.


Në mënyrë që të identifikojmë sa më mirë kërkesat dhe planifikimet buxhetore për vitet 2026-2028 të programeve të AKP-së, Departamenti i Financave dhe Buxhetit i Agjencisë ka kërkuar nga mbajtësit e buxhetit të dhënat për planifikimin trevjeçar dhe pas pranimit të informatave të cilat i kemi analizuar në detaje kemi përgatitur dokumentin e KASH-it dhe letrën përcjellëse.

Dokumenti i KASH-it përfshinë shpenzimet e vitit 2024, buxhetin e aprovuar të vitit 2025 dhe shpenzimet e parashikuara operative dhe kapitale të AKP-së për vitet 2026-2028.

Duke u bazuar në të lartcekurat Bordi vendosi si më lartë.

Prishtinë, më 27 mars 2025.





Nr. Ref. BD-221/5

Në bazë të neneve Neni 1, 2, 5, 6, 8, 9, 15.2.1 dhe 15.2.12 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullat e Përgjithshme të Tenderit për shitjen e aseteve në likuidim dhe Procedurave të shitjes për shitjen e aseteve në likuidim, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 27 mars 2025 nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Aprovohet lista e aseteve për shitje në ShAL 72 me gjithsej 43 asete dhe me gjithë depozitat e propozuara.
- II. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për aprovim të listës së aseteve për Shitje të Aseteve përmes Likuidimit ShAL 72. Në bazë të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, AKP ka zotësi të plotë juridike, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj.

Në këtë kontekst një ndër detyrat themelore të Agjencisë është procesi i shitjes së pronave shoqërore në mbarë territorin e Kosovës dhe jashtë sajë. Ndër format e shitjeve që i përdorë Agjencia Kosovare e Privatizimit është shitja përmes tenderit publik dhe atë kryesisht nëpërmes grupimit të aseteve në Shitje të Aseteve përmes Likuidimit (ShAL).

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 mars 2025.



Nr. i aseteve
10
2
10
12
9
43

asete të bujqësi
banorë
barnatore
bedrum
depa
depa dhe toke
depa e derivateve

arë
gurorë
kultivë
livadh
makineri
mal
objekt i fortë
fabrikë

Nr.	Regjioni	Emri i NSH-së	Emri i Asetit	Kategoria sipas dokumenteve pronësore	Kategoria e asetit për aprovim	Cmimi Orientues për publikim €/ar/m2	Përshkrimi i shkurtër i asetit	Komuna	Lokacioni (Fshati, Çyteti)	Sipërfaqja e tokës m ²	Ha	Depozita	Link 1	Link 2	Kategoria e potencialit të pronës për shfrytëzimit sipas vendimit të Bordit	Cmimi Orientues për publikim sipas vendimit të BD €/ar/m2
						199,561				10000		20				
1	Gjilan	Pasuria Bujqësore	Pasuria Bujqësore Toka në Prelez i Muhashervë (Lot C)	Tokë bujqësore	Rezidenciale	2,000 €/ari	Tokë bujqësore, parcela nr. P-72209060-00466-0, arë 4, sipas certifikatës së pronës.	Ferizaj	Prelez i Muhashervë	6961	0.70	7,000 €	Linku		Pronë rezidenciale	2,000 €/ari
2	Gjilan	K.B Morava Partesh	Morava Partesh Budriga e Poshtme (Lot B)	Tokë bujqësore	Rezidenciale	2,500 €/ari	Tokë bujqësore, parcela nr. P-73603018-00148-0, arë 2, sipas certifikatës së pronës.	Partesh	Budriga e Poshtme	5798	0.58	7,000 €	Linku		Pronë komerciale - për objekt komercial	6,500 €/ari
3	Gjilan	K.B Morava Partesh	Morava Partesh Budriga e Poshtme (Lot C)	Tokë bujqësore	Rezidenciale	1,500 €/ari	Tokë bujqësore, parcela nr. P-73603018-00151-0 dhe P-73603018-00152-0, arë 2 sipas certifikatës së pronës.	Partesh	Budriga e Poshtme	7278	0.73	5,000 €	Linku		Pronë komerciale - për objekt komercial	4,750 €/ari
4	Gjilan	Zhivko Vasić	Zhivko Vasić Toka në Petroc (Lot D)	Tokë bujqësore	Bujqësore - Kullose	100 €/ari	Tokë bujqësore, parcela nr. P-71107062-00007-0 mal 4 dhe P-71107062-00008-0 arë 7, sipas certifikatës së pronës.	Kamenicë	Petroc	7828	0.78	1,000 €	Linku		Pronë bujqësore - kullosë	100 €/ari
5	Gjilan	N.B.I Agromorava	Agromorava Toka në Budrigë e Epërme (Lot A)	Tokë bujqësore	Bujqësore - Arë	140 €/ari	Tokë bujqësore, parcela nr. P-70101012-00924-0 livadh 1 dhe 2, sipas certifikatës së pronës.	Viti	Budrigë e Epërme	6749	0.67	1,000 €	Linku		Pronë bujqësore - arë	140 €/ari
6	Gjilan	N.B.I Agromorava	Agromorava Toka në Budrigë e Epërme (Lot B)	Tokë bujqësore	Bujqësore - Arë	140 €/ari	Tokë bujqësore, parcela nr. P-70101012-00936-0 livadh 2, sipas certifikatës së pronës.	Viti	Budrigë e Epërme	3574	0.36	500 €	Linku		Pronë bujqësore - arë	140 €/ari
7	Gjilan	N.B.I Agromorava	Agromorava Toka në Goshicë (Lot A)	Tokë bujqësore	Bujqësore - Kullose	200 €/ari	Tokë bujqësore, parcela nr. P-70101016-00968-0 dhe P-70101016-00969-0 kullosë 3, sipas certifikatës së pronës.	Viti	Goshicë	5022	0.50	1,000 €	Linku		Pronë bujqësore - kullosë	200 €/ari
8	Gjilan	N.B.I Agromorava	Agromorava Toka në Pozharanë (Lot F)	Tokë bujqësore	Rezidenciale	3,000 €/ari	Tokë bujqësore, parcela nr. P-70101033-00350-0 arë 3, sipas certifikatës së pronës.	Viti	Pozharanë	7424	0.74	10,000 €	Linku		Pronë rezidenciale	3,000 €/ari
9	Gjilan	Tefik Çanga	Tefik Çanga Toka në Busi (Lot B)	Tokë bujqësore	Rezidenciale	1,500 €/ari	Tokë bujqësore, parcela nr. P-71914008-00795-0 kullosë 5, sipas certifikatës së pronës.	Frishtinë	Busi	464	0.05	500 €	Linku		Pronë rezidenciale	1,500 €/ari
10	Gjilan	Tefik Çanga	Tefik Çanga Toka në Busi (Lot C)	Tokë bujqësore	Rezidenciale	1,500 €/ari	Tokë bujqësore, parcela nr. P-71914008-03524-0 dhe P-71914008-03572-0 livadh 5, sipas certifikatës së pronës.	Frishtinë	Busi	2793	0.28	4,000 €	Linku		Pronë rezidenciale	1,500 €/ari
11	Mitrovica	NSH Transkosoza	Depoja e vjetër e Transkosoza në Zhabar të Epërm	objekt	Komerciale - Depo	255 €/m2	Objekti afarisht/ depoja e vjetër me sipërfaqe 1042m2	Mitrovicë	Mitrovicë	1,039	0.10	25,000 €	LINKU		Komerciale - Depo	255 €/m2
12	Mitrovica	NSH Produkti	Ngastra 1064-0 në ZK	Tokë bujqësore - arë i klasës 5	Bujqësore - Kullose	250 €/ari	Tokë bujqësore, parcela 1064/0 me sipërfaqe 2251 m2 në Klinë të Epërme	Skenderaj	Klinë e Epërm	2,251	0.23	500 €	LINKU		Pronë rezidenciale	2,000 €/ari
13	Peja	Enti për Terapi Fizikale	Parcela nr. 126-9 ZK Balicë	Tokë ndërtimore	Rezidenciale	1,800 €/ari	Kjo shitje përfshinë parcelën nr. 126-9, me kulturë tokë ndërtimore/oborr në sipërfaqe 558 m ² , që ndodhet në ZK Balicë, Istog.	Istog	Balicë	558	0.05	1,000 €	Linku		Pronë rezidenciale	1,800 €/ari

MKT

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

Nr.	Regjioni	Emri (NSH-48)	Emri i Astit	Kategoria sipas dokumenteve pronesore	Kategoria e asetit per aprovim	Cmimi Orientues per publikim €/ari/m2	Pershkrimi i shkurtër i asetit	Komuna	Lokacioni (fshati, Qytej)	Sipërfaqja e tokës m²	Ita	Depozita	Link 1	Link 2	Kategoria e potencialit të pronës për shfrytëzimit sipas vendimit të Bordit	Cmimi Orientues per publikim sipas vendimit të BO €/ari/m2
14	Peja	KB Gurakoci	KB Gurakoci-Parcela nr.399-2 dhe 400-2 ZK Kovragë	Tokë bujqësore	Bujqësore - Are	200 €/ari	Kjo shpërfaqja përfshinë parcelën nr.399-2 me kulturë livadhi I klasës 5 në sipërfaqe 2630 m² si dhe parcelën 400-2 me kulturë livadhi në sipërfaqe 3807m², në sipërfaqe të përgjithshme 6437m², që ndodhet në ZK Kovragë, Istog.	Istog	Kovragë	6,437	0.64	1,000 €	Linku		Pronë bujqësore - arë	200 €/ari
15	Peja	KB Burimi	KB Burimi -Parcela nr.177-2 dhe 177-3 ZK Balçë	Tokë bujqësore	Rezidenciale	1,800 €/ari	Kjo shpërfaqja përfshinë parcelën nr. 177-2 me kulturë livadhi I klasës 4 në sipërfaqe 948m² si dhe parcelën 177-3 me kulturë arë e klasës 4 në sipërfaqe 6808 m², në sipërfaqe të përgjithshme 7756 m², që ndodhet në ZK Balçë.	Istog	Balçë	7,756	0.78	7,000 €	Linku		Pronë rezidenciale	1,800 €/ari
16	Peja	NPB Malishgan	NPB Malishgan parcela 140-3 ZK Klinave	Tokë bujqësore	Bujqësore - Are	220 €/ari	Kjo shpërfaqja përfshinë parcelën nr.148-3 me kulturë arë e klasës 5, në sipërfaqe 3238 m², që ndodhet në ZK Klinave, Klinë.	Klinë	Klinave	3,238	0.32	1,000 €	Linku		Pronë rezidenciale	1,500 €/ari
17	Peja	NSH Dubrava	NSH Dubrava-Parcelat nr. 192-11, 192-12 dhe 192-13, ZK Kërninë	Tokë Ndërtimore/bujqësore	Bujqësore - Are	200 €/ari	Kjo shpërfaqja përfshinë parcelën nr. 192-11 me kulturë tokë ndërtimore-oborr-shtëpi/arë e klasës 5 në sipërfaqe 1716 m², parcelën nr. 192-12 me kulturë tokë ndërtimore-oborr-shtëpi/arë e klasës 5 në sipërfaqe 1205 m² si dhe parcelën nr. 192-13 me kulturë tokë ndërtimore-oborr-shtëpi/arë e klasës 5 në sipërfaqe 2760 m², në sipërfaqe të përgjithshme 5681 m², që ndodhen në ZK Kërninë, Istog.	Istog	Kërninë	5,681	0.57	1,000 €	Linku		Pronë bujqësore - arë	200 €/ari
18	Peja	KB Gurakoci	KB Gurakoci- Parcela 212-1-O ZK Tomoc	Tokë	Rezidenciale	1,500 €/ari	Kjo shpërfaqja përfshinë parcelën nr. 212-1 me kulturë kullës e klasës 3, në sipërfaqe 2870 m², që ndodhet në ZK Tomoc.	Istog	Tomoc	2,870	0.29	4,000 €	Linku		Pronë komerciale - për objekt komercial	2,300 €/ari
19	Peja	NSH Bujqësia	NSH Bujqësia - Parcela nr. 2-8, 10-4 dhe 10-6 ZK Poterq I Epërm	Tokë bujqësore	Rezidenciale	1,350 €/ari	Kjo shpërfaqja përfshinë parcelën nr. 2-8 me kulturë arë e klasës 5 në sipërfaqe 1766 m², parcelën nr. 10-4 me kulturë arë e klasës 5 në sipërfaqe 154 m² dhe parcelën nr. 10-6 me kulturë arë e klasës 5 në sipërfaqe 1682m² në sipërfaqe të përgjithshme 1836 m², në ZK Poterq I Epërm, Klinë.	Klinë	Poterq I Epërm	3,602	0.36	5,000 €	Linku		Pronë rezidenciale	1,350 €/ari
20	Peja	NSH Ereniku Prodhimtaria Primare	NSH Ereniku - Parcela nr. 755-4 në ZK Korenicë	Tokë bujqësore	Rezidenciale	1,000 €/ari	Kjo shpërfaqja përfshinë parcelën nr. 755-4 në me kulturë arë e kalës 4, në sipërfaqe 7104 m², që ndodhet në ZK Korenicë, Gjakovë.	Gjakovë	Korenicë	7,104	0.71	7,000 €	Linku		Pronë rezidenciale	1,000 €/ari
21	Peja	NSH Ereniku Prodhimtaria Primare	NSH Ereniku - Parcela n. 109-2 në ZK Fierzë	Tokë bujqësore	Rezidenciale	2,500 €/ari	Kjo shpërfaqja përfshinë parcelën nr. 109-2 me kulturë arë e klasës 5 në sipërfaqe 3202 m², që ndodhet në ZK Fierzë, Gjakovë.	Gjakovë	Fierzë	3,202	0.32	8,000 €	Linku		Pronë rezidenciale	2,500 €/ari
22	Peja	NSH Ereniku Prodhimtaria Primare	NSH Ereniku - Parcela nr. 1011 dhe 1012 në ZK Shishmon I Bokës	Tokë bujqësore	Bujqësore - Are	250 €/ari	Kjo shpërfaqja përfshinë parcelën nr. 1011-0 me kulturë mal i kalës 3 me sipërfaqe 290m² dhe parcelën nr.1012-0 me me kulturë livadhi I klasës 5, në sipërfaqe 8507m², me sipërfaqe të përgjithshme 8797 m², që ndodhet në ZK Shishmon I Bokës.	Gjakovë	Shishmon I Bokës	8,797	0.88	2,000 €	Linku		Pronë rezidenciale	600 €/ari
23	Prishtina	Ratar	Ratar Tokë Bujqësore Matigan - 767-O	Tokë bujqësore	Komerciale - ndërtim komercial	75,000 €/ari	Tokë bujqësore, parcela 767-O me sipërfaqe 2156m²	Prishtinë	Matigan	2,156	0.22	80,000 €	Linku		Pronë komerciale - për objekt komercial	75,000 €/ari

Mh

Nr.	Regjioni	Emri/Insti-të	Emri / Aseti	Kategoria sipas dokumenteve pronësore	Kategoria e asetit për aprovim	Çmimi Orientues për publikim sipas €/ari/m2	Pershkrimi i shkurter i asetit	Komuna	Lokacioni (shant, Qyteti)	Sipërfaqja e tokës m ²	Ha	Depozita	Link 1	Link 2	Kategoria e potencialit të pronës për shfrytëzimit sipas vendimit të Bordit	Çmimi Orientues për publikim sipas vendimit të BD €/ari/m2
24	Prishtina	Ratar	Ratar Tokë Bujqësore Graçanicë 2155-08/2156-0	Tokë bujqësore	Bujqësore - Are	550 €/ari	Tokë bujqësore, parcelat 2155-0 dhe 2156-0 me sipërfaqe të përgjithshme 9418m2	Graçanicë	Graçanicë	9,418	0.94	5,000 €	Linku		Pronë bujqësore - arë	550 €/ari
25	Prishtina	Ratar	Ratar Tokë Bujqësore Llaplasejë - 1508-0	Tokë bujqësore	Bujqësore - Are	550 €/ari	Tokë bujqësore, parcela 1508-0 me sipërfaqe 7614m2	Graçanicë	Llaplasejë	7,614	0.76	4,000 €	Linku		Pronë komerciale - për objekt komercial	3,000 €/ari
26	Prishtina	Ratar	Ratar Tokë Bujqësore Preoc - 75-0	Tokë bujqësore	Komerciale - ndërtim komercial	700 €/ari	Tokë bujqësore, parcela 75-0 me sipërfaqe 7325m2	Graçanicë	Preoc	7,325	0.73	5,000 €	Linku		Pronë komerciale - për objekt komercial	8,000 €/ari
27	Prishtina	Ratar	Ratar Tokë Bujqësore Preoc - 101-0	Tokë bujqësore	Komerciale - ndërtim komercial	2,500 €/ari	Tokë bujqësore, parcela 101-0 me sipërfaqe 5183m2	Graçanicë	Preoc	5,183	0.52	7,000 €	Linku		Pronë komerciale - për objekt komercial	2,500 €/ari
28	Prishtina	Ratar	Ratar Tokë Bujqësore Preoc - 178-0	Tokë bujqësore	Bujqësore - Are	700 €/ari	Tokë bujqësore, parcela 178-0 me sipërfaqe 5005m2	Graçanicë	Preoc	5,005	0.50	3,500 €	Linku		Pronë komerciale - për objekt komercial	2,500 €/ari
29	Prishtina	Ratar	Ratar Tokë Bujqësore Preoc - 184-2	Tokë bujqësore	Bujqësore - Are	700 €/ari	Tokë bujqësore, parcela 184-2 me sipërfaqe 750m2	Graçanicë	Preoc	750	0.08	500 €	Linku		Pronë komerciale - për objekt komercial	2,500 €/ari
30	Prishtina	Ratar	Ratar Tokë Bujqësore Preoc - 188-1	Tokë bujqësore	Bujqësore - Are	700 €/ari	Tokë bujqësore, parcela 188-1 me sipërfaqe 6524m2	Graçanicë	Preoc	6,524	0.65	5,000 €	linku		Pronë komerciale - për objekt komercial	2,500 €/ari
31	Prishtina	KB Lavërtari-Blegtori	Lavërtari-Blegtori Tokë Bujqësore Preoc - 580-1	Tokë bujqësore	Bujqësore - Are	700 €/ari	Tokë bujqësore, parcela 580-1 me sipërfaqe 3306m2	Graçanicë	Preoc	3,306	0.33	2,500 €	Linku		Pronë komerciale - për objekt komercial	2,500 €/ari
32	Prishtina	KB Kosova	KB Kosova Tokë Bujqësore Livagjë - 1593-08/1594-0	Tokë bujqësore	Komerciale - ndërtim komercial	5,000 €/ari	Tokë bujqësore, parcelat 1593-0 dhe 1594-0 me sipërfaqe të përgjithshme 4496m2	Graçanicë	Livagjë	4,496	0.45	20,000 €	Linku		Pronë komerciale - për objekt komercial	5,000 €/ari
33	Prishtina	KB Flora	KB Flora Tokë Bujqësore Pakashitë e Poshtme II	Tokë bujqësore	Rezidenciale	500 €/ari	Tokë bujqësore me kulturë arë, ngastra kadastrale 149-0 dhe 150/0 ZK Pakashitë e Poshtme me sipërfaqe të përgjithshme 1940m2	Podujevë	Pakashitë e Poshtme	1,940	0.19	1,000 €	Linku		Pronë rezidenciale	500 €/ari
34	Prishtina	KB Flora	KB Flora Tokë Bujqësore Pakashitë e Poshtme III	Tokë bujqësore	Rezidenciale	500 €/ari	Tokë bujqësore me kulturë arë, ngastra kadastrale 161-0, 162/0 dhe 163/0 ZK Pakashitë e Poshtme me sipërfaqe të përgjithshme 7900m2	Podujevë	Pakashitë e Poshtme	7,900	0.79	4,000 €	Linku		Pronë rezidenciale	500 €/ari
35	Prizren	NB Mirusha	NSH NB Mirusha - Parcelat 311-0 dhe 313-0 - ZK Lubizhdë Malishevë	Tokë bujqësore	Bujqësore - Are	380 €/ari	NSH NB Mirusha - Parcelat 311-0 dhe 313-0 - ZK Lubizhdë Malishevë - ofron për shitje pronën me sipërfaqe të përgjithshme prej 6319 m ² , që përfshin ngastrat kadastrale: P-72310044-00311-0 me sipërfaqe prej 3599 m ² dhe P-72310044-00313-0 me sipërfaqe prej 2720 m ² , me kulturë "arë kl.4", që gjenden në ZK Lubizhdë, Komuna Malishevë.	Malishevë	Lubizhdë	6,319	0.63	2,500 €	Linku	Linku2	Pronë rezidenciale	2,000 €/ari
36	Prizren	NB Mirusha	NSH NB Mirusha - Parcela 721-0 - ZK Turjakë Malishevë	Tokë bujqësore	Bujqësore - Are	380 €/ari	NSH NB Mirusha - Parcela 721-0 - ZK Turjakë Malishevë - ofron për shitje ngastrën kadastrale P-72310076-00721-0 me kulturë "livadh kl.4", me sipërfaqe prej 3766 m ² , që gjendet në ZK Turjakë, Komuna Malishevë.	Malishevë	Turjakë	3,766	0.38	1,500 €	Linku		Pronë rezidenciale	2,000 €/ari

u.k.

AGENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

Nr.	Regjioni	Emri i NSh-të	Emri i Astit	Kategoria sipas dokumenteve pronësore	Kategoria e asetit për aprovim	Cmimi Orientues për publikim €/ar/m2	Pershkrimi i shkurtër i asetit	Komuna	Lokacioni (Fshati, Qyteti)	Sipërfaqja e tokës m²	Ha	Depejta	Link 1	Link 2	Kategoria e potencialit të pronës për shfrytëzimit sipas vendimit të Bordit	Cmimi Orientues për publikim sipas vendimit të BD €/ar/m2
37	Prizren	NB Mirusha	NSH NB Mirusha - Parcelat 928-0 dhe 929-0 - ZK Turjakë Malishevë	Tokë bujqësore	Bujqësore - Are	380 €/ar	NSH NB Mirusha - Parcelat 928-0 dhe 929-0 - ZK Turjakë Malishevë - ofron për shitje pronën me sipërfaqe të përgjithshme prej 3321 m², që përfshin ngastrat kadastrale: P-72310076-00928-0 me sipërfaqe prej 520 m² dhe P-72310076-00929-0 me sipërfaqe prej 2801 m², me kulturë "livadh, anë kl.6", që gjenden në ZK Turjakë, Komuna Malishevë.	Malishevë	Turjakë	3,321	0.33	1,000 €	Linku	Linku2	Pronë rezidenciale	2,000 €/ar
38	Prizren	NB Mirusha	NSH NB Mirusha - Parcelat 1858-0 dhe 1879-0 - ZK Kijevë Malishevë	Tokë	Rezidenciale	2,500 €/ar	NSH NB Mirusha - Parcelat 1858-0 dhe 1879-0 - ZK Kijevë Malishevë - ofron për shitje pronën me sipërfaqe të përgjithshme prej 419 m², që përfshin ngastrat kadastrale: P-72310037-01858-0 me sipërfaqe prej 316 m² dhe P-72310037-01879-0 me sipërfaqe prej 103 m², me kulturë "shtëpi-ndërtësë", që gjenden në ZK Kijevë, Komuna Malishevë. Shënim: Sipas vizitës në terren është konstatuar se në terren nuk ekziston ndonjë objekt por është tokë e punuar në vendin e quajtur "Progonice-Shtalla".	Malishevë	Kijevë	419	0.04	1,000 €	Linku1	Linku2	Pronë rezidenciale	2,500 €/ar
39	Prizren	NB Mirusha	NSH NB Mirusha - Parcela 1994-0 - ZK Kijevë Malishevë	Tokë bujqësore	Bujqësore - Are	380 €/ar	NSH NB Mirusha - Parcela 1994-0 - ZK Kijevë Malishevë - ofron për shitje ngastrën kadastrale P-72310037-01994-0 me kulturë "arë kl.5", me sipërfaqe prej 2799 m², që gjendet në ZK Kijevë, Komuna Malishevë.	Malishevë	Kijevë	2,799	0.28	1,000 €	Linku		Pronë rezidenciale	2,500 €/ar
40	Prizren	D.LB Lavertari Biegtori	NSH DLB - Parcelat 1363-0 dhe 1364-0 - ZK Lubizhdë Prizren	Tokë bujqësore	Rezidenciale	8,000 €/ar	NSH DLB - Parcelat 1363-0 dhe 1364-0 - ZK Lubizhdë Prizren - ofron për shitje tokën bujqësore me sipërfaqen totale prej 3740 m² që ndodhet në Zonën kadastrale Lubizhdë dhe përfshin ngastrat kadastrale P-71813046-01363-0 me sipërfaqe prej 2690 m² (arë kl.4) dhe P-71813046-01364-0 me sipërfaqe prej 1050 m² (arë kl.4) të regjistruara në emër të NSh-së në Certifikatën për të Drejtat Pronësore të Pasurisë së Paluajtshme.	Prizren	Lubizhdë	3,740	0.37	15,000 €	Linku1	Linku2	Pronë rezidenciale	8,000 €/ar
41	Prizren	NBI Rahoveci	NSH NBI Rahoveci - Parcela 410-0 - ZK Xërë Rahovec	Tokë bujqësore	Bujqësore - Are	340 €/ar	NSH NBI Rahoveci - Parcela 410-0 - ZK Xërë Rahovec - ofron për shitje tokën bujqësore që ndodhet në Zonën kadastrale Xërë dhe përfshin ngastrën kadastrale P-71510033-00410-0 me sipërfaqe prej 2398 m² (arë kl.4) e regjistruar në emër të NSh-së në Certifikatën për të Drejtat Pronësore të Pasurisë së Paluajtshme.	Rahovec	Xërë	2398	0.24	1,000 €	Linku		Pronë bujqësore - arë	340 €/ar
42	Prizren	NBI Rahoveci	NSH NBI Rahoveci - Parcela 495-3 - ZK Xërë Rahovec	Tokë bujqësore	Bujqësore - Are	340 €/ar	NSH NBI Rahoveci - Parcela 495-3 - ZK Xërë Rahovec - ofron për shitje tokën bujqësore që ndodhet në Zonën kadastrale Xërë dhe përfshin ngastrën kadastrale P-71510033-00495-3 me sipërfaqe prej 4534 m² (vreshtë kl.2) e regjistruar në emër të NSh-së në Certifikatën për të Drejtat Pronësore të Pasurisë së Paluajtshme.	Rahovec	Xërë	4534	0.45	1,500 €	Linku		Pronë rezidenciale	4,500 €/ar

MH

Nr.	Regjioni	Emri i NSh-së	Emri i Astit	Kategoria sipas dokumenteve pronësore	Kategoria e asetit për aprovim	Cmimi Orientues për publikim €/ar/m2	Pershkrimi i shkurter i asetit	Komuna	Lokacioni (Fshat, Qyteti)	Sipërfaqja e tokës m ²	Ha	Depozita	Link 1	Link 2	Kategoria e potencialitetit pronës për shfrytëzimit sipas vendimit të Bordit	Cmimi Orientues për publikim sipas vendimit të BD €/ar/m2
43	Prizren	NBI Rahoveci	NSH NBI Rahoveci - Parcelat 2148-0 dhe 2163-0 - ZK Ratkoc Rahovec	Tokë bujqësore	Bujqësore - Are	280 €/ar	NSH NBI Rahoveci - Parcelat 2148-0 dhe 2163-0 - ZK Ratkoc Rahovec - ofron për shitje tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme 4222 m ² që ndodhet në Zonën Kadastrale Ratkoc Rahovec dhe përfshin ngastrat kadastrale P-71510068-02148-0 me sipërfaqe prej 3234 m ² (arë kl.6) dhe P-71510068-02163-0 me sipërfaqe prej 988 m ² (arë kl.5), prona të regjistruara në emër të NSH-së në Certifikatën për të Drejtat Pronësore të Pasurisë së Paluajtshme	Rahovec	Ratkoc	4222	0.42	1,000 €	Linku1	Linku2	Pronë bujqësore - arë	280 €/ar



Nr. Ref. BD-221/6

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), në mbështetje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e palëve _____ e cila kërkesë është parashtruar nga _____, në cilësinë e të autorizuarit të të gjithë trashëgimtarëve të së drejtës banesore, ku bartës i së drejtës banesore është _____ (tani i ndjerë) me numër KB-1819/18 përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 18.03.2025 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "Amortizatorët" Prishtinë (PRN047).
- II. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv që të nënshkruajë kontratën e shitblerjes.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 18.03.2025 me anë të cilit aprovohet si e bazuar kërkesa e parashtruesit së kërkesës: _____ në cilësinë e personit të autorizuar nga trashëgimtarët ligjorë të bartësit të së drejtës banesore (_____ ku bartës i së drejtës banesore është _____ (tani i ndjerë) për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "Amortizatorët" Prishtinë (PRN047).

Bordi në pajtim me mandatin e tij shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që konstatoi se kërkesa e palës i plotëson kushtet ligjore për blerjen e banesës, dhe e cila shërben si bazë për realizimin e të drejtës banesore, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 mars 2025.





Nr. Ref. BD-221/7

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), në mbështetje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e parashtrueses së kërkesës në cilësinë e personit të autorizuar nga trashëgimtarët ligjorë të bartësit të së drejtës banesore dhe ku bartësi i së drejtës banesore është me numër KB-1813/24 përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 18.03.2025 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "Jugoauto" Beograd, Njësia në Prishtinë (PRN120).
- II. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv që të nënshkruajë kontratën e shitblerjes.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 18.03.2025 me anë të cilit aprovohet si e bazuar kërkesa e parashtrueses së kërkesës në cilësinë e personit të autorizuar nga trashëgimtarët ligjorë të bartësit të së drejtës banesore ku bartësi i së drejtës banesore është për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "Jugoauto" Beograd, Njësia në Prishtinë (PRN120).

Bordi në pajtim me mandatin e tij shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që konstatoi se kërkesa e palës i plotëson kushtet ligjore për blerjen e banesës, dhe e cila shërben si bazë për realizimin e të drejtës banesore, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 mars 2025.





Nr. Ref. BD-221/8

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës [redacted] i autorizuar nga [redacted] me numër KB-1400/16 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 18.03.2025 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH OPPB "Ramiz Sadiku" Prishtine (PRN035).
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 18.03.2025 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës [redacted] i autorizuar nga [redacted] për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH OPPB "Ramiz Sadiku" Prishtine (PRN035). Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e palës janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se pala nuk kishte lidhur Kontratë të Shfrytëzimit të Banesës me BVI Banesore, këtë fakt e ka konfirmuar Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë me datë 11.03.2025. Andaj Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86).

Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 mars 2025.





Nr. Ref. BD-221/9

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës [] përfaqësuar sipas autorizimit nga [] - ku bartës i të drejtës banesore është [] (tani e ndjerë) me numër 1811/24 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 18.03.2025 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "Fabrika e Amortizatorëve", Prishtinë (PRN047).
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 18.03.2025 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës [] përfaqësuar sipas autorizimit nga [] - ku bartës i të drejtës banesore është [] (tani e ndjerë) për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "Fabrika e Amortizatorëve", Prishtinë (PRN047). Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e palës janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se palës i mungon kontrata mbi shfrytëzimin e banesës BVI banesore. Andaj, komisioni konstaton se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 mars 2025.





Nr. Ref. BD-221/10

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës përfaqësuar sipas autorizimit nga me numër 1665/22 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 18.03.2025 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "Fabrika e Gypave"- Ferizaj (GJI053).
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 18.03.2025 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës, i përfaqësuar sipas autorizimit nga për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH Fabrika e Gypave, Ferizaj (GJI053). Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e palës janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se palës i mungon i mungon kontrata për shfrytëzimin e banesës si dhe vendimi mbi ndarjen e banesës nga NSH-së, të pa vërtetuara edhe pas përpjekjeve të Komisionit për të siguruar dokumentet e vërtetuara nga pala. Pala ka deklaruar se nuk ka mundësi ti siguroj Dokumentet e vërtetuara në Komunën e Ferizajt

Andaj, komisioni konstaton se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 mars 2025.





Nr. Ref. BD-221/11

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banësive mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës , përfaqësuar sipas autorizimit nga me numër 1801/24 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banësive të datës 18.03.2025 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "Bujqësia" Fushë Kosovë (PRN082)
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 18.03.2025 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "Bujqësia" Fushë Kosovë (PRN082). Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banësive për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banësive") lidhur me kërkesën e palës janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjeti se pala nuk posedon Kontratën mbi shfrytëzimin e banesës, ndërsa pala ka kërkuar vet tërheqjen e lëndës nga Komisioni për Banesa për trajtim të mëtutjeshëm në Divizionit për Shitje Direkte, ndërsa Divizioni për Shitje Direkte ka konfirmuar ekzistencën e kësaj lënde pranë këtij Divizioni. Bazuar në kërkesën e Komisionit për verifikim, me datë 12 mars 2025 është pranuar përgjigja nga Komuna e Fushë Kosovës ku në mes tjerash theksohet se *"Në arkivin tonë të banësive të vjetra, që na janë ofruar nga Ndërmarrja Banesore në Prishtinë, që i përkasin Komunës së Fushë Kosovës, nuk ka ndonjë emër të familjës"*.

Andaj, komisioni konstaton se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 mars 2025.





Nr. Ref. BD-221/12

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës përfaqësuar sipas autorizimit nga ne numër 1585/20 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 18.03.2025 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "Ballkan", Suharekë (PRZ014).
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 18.03.2025 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "Ballkan", Suharekë (PRZ014). Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e palës janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe gjetet se kjo kërkesë konsiderohet e përmbyllur. Andaj, komisioni konstaton se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, si dhe nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86).

Andaj, komisioni konstaton se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 mars 2025.





Nr. Ref. BD-221/13

Në bazë të nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Menaxhmentit të AKP-së që qiramarrësit "Alfa Minerals & Alloy" LTD t'i aprovohet kërkesa për lirim nga detyrimi apo zbritjen/shlyerjen e detyrimeve në vlerën bruto prej 11,200.00Euro (320.00*35muaj) për periudhën Maj 2019 deri në Prill 2022 për asetin "Depoja e lëndës parë - fabrika e telit Gjakovë" NSh Metaliku.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e zbritjes së çmimit të qiradhënies sipas dispozitivit të këtij vendimi duke u bazuar në faktet si në vijim

y vendim u aprovua:

Qiramarrësi Alfa Minerals edhe me herët ka kontestuar pagesën e qirasë për asetin/depo e lëndës së parë fabrika e telit për periudhën kur kanë qenë të vendosura mbetjet kimike, respektivisht për periudhën nga muaji maj 2019 deri me 31 mars 2022 ndërsa i njëjti e ka nënshkruar vazhdimin e kontratës së qirasë dhe në fillim ka paguar qiranë me rregull deri në kërkesën e parashtruar për lirimin e pagesës së qirasë.

Nga Menaxhmenti i NSh "Metaliku" Agjencia ka njoftuar se në këtë objekt nga ana e KFOR-it janë identifikuar mbetje kimike të rrezikshme që nga viti 1999, të cilat janë mbikëqyrë nga ana e Njësisë të KFOR-it, FSK-së dhe nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë çdo 6 (gjashtë) muaj.

Përfaqësuesit e Ndërmarrjes Metaliku në Gjakovë, kanë kërkuar nga këto njësi që të bëhet dislokimi i mbetjeve kimike, mirëpo njësia e KFOR-it, FSK dhe MMPH i kanë njoftuar se dislokimi ka një kosto dhe duhet të sigurohet një vend i sigurt për vendosjen e mbetjeve kimike. Ndërmarrja në atë kohë nuk ka pas mjete financiare për sigurimin e materialeve të nevojshme për ri-ambalazhimin e mbetjeve industriale.

Alfa Minerals gjatë vizitës në terren është njoftuar nga Menaxhmenti i Ndërmarrjes se depo e lëndës së parë për momentin nuk mund të shfrytëzohet për shkak të prezencës së disa mbetjeve kimike të cilat janë në monitorim të KFOR-it dhe FSK. Megjithatë ai ka kërkuar që e njëjta të shpallët në tender dhe se ka interesim për qiramarrje. Në vitin 2019, Alfa Minerals and Alloys ka shprehë interesim për marrje me qira për katër asetet e Ndërmarrjes në mesin e tyre edhe për objektin depoja e lëndës së parë-fabrika e telit. Pas marrjes me qira të asetit Menaxhmenti i Ndërmarrjes ka njoftuar KFOR-in dhe FSK se aseti në fjalë është dhënë me qira dhe në këtë kontekst qiramarrësi mban përgjegjësi për këto mbetje kimike. Çdo vizitë nga ana e KFOR-it dhe FSK është bërë me prani të përfaqësuesve të qiramarrësit. Ka qenë i njoftuar se koha kur lirohet objekti nga mbetjet kimike nuk është e përcaktuar.

Pas marrjes me qira Alfa Minerals and Alloys disa here ka diskutuar dhe kërkuar për dislokimin e mbetjeve kimike, mirëpo është kërkuar të gjendet një vend i sigurt sipas standardeve të KFOR-it dhe FSK-së për dislokimin e tyre. Pjesa financiare është dashtë të mbulohet nga Ndërmarrja

Bazuar në të lartcekurat, Bordi ka konstatuar se nga dita e shpalljes së tenderit për asetin "Depoja e lëndës parë - fabrika e telit Gjakovë" e deri të nënshkrimi i kontratës së qirasë, nuk ka pasur njohuri lidhur me këto mbetje kimike

MH



të rrezikshme që nga viti 1999 të cilat më pas, të vendosura në 49 fuqi janë dislokuar në objektin e neutralizimit. Prandaj, përfundimisht duhet marrë në konsideratë këtë fakt meqë ka qenë obligim i yni që fillimisht të mos e tenderojmë këtë pjesë apo hapësirat e “Depoja e lëndës parë - fabrika e telit Gjakovë” për qiradhënie derisa të largoheshin këto mbetje kimike.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 mars 2025





Nr. Ref. BD-221/14

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, nenit 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; nenit 10.1.5 i Rregullores Nr. Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; Nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve; dhe neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të:

- a) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit material i vrazhdë nr. 12/A – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 143.00 €/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Xhemajl Radosta.
- b) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit material i vrazhdë nr. 189 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 119.00 €/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Baftir Mustafa.
- c) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit material i vrazhdë nr. 470 dhe 471 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 129.00 €/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Fatmir Azemi.
- d) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit konstruksion metalik nr. 96 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 56.00 €/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Sofije Maloku.
- e) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit konstruksion metalik nr. 740 dhe 741 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 56.00 €/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Bedri Rudari.
- f) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit material i vrazhdë nr. 29A – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 99.00 €/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Olti Imeri.
- g) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit material i vrazhdë nr. xx – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 437.00 €/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Imer Imeri (ADI 2007).
- h) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit material i vrazhdë nr. 30A – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 99.00 €/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Hamdi Imeri.
- i) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit konstruksion metalik nr. 649 dhe 650 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 56.00 €/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Xhemajl Radosta.
- j) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit konstruksion metalik nr. 101,102,103, 128,129 dhe 130 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 167.00 €/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Afrim Sylja.
- k) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit konstruksion metalik nr. 493 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 27.00 €/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Qamil Lalloshi.
- l) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit konstruksion metalik nr. 494 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 27.00 €/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Arton Fazliu.



- m) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit konstruksion metalik nr. 63 dhe 66 dhe 67 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 83.00 €/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Naim Berisha.
- n) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit konstruksion metalik nr. 14/A1 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 119.00 €/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Valon Beqiri.
- o) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit konstruksion metalik nr. 272–274, 364, 365 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 139.00 €/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Skender Pireva.
- p) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit konstruksion metalik nr. 405 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 28.00 €/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Bekim Prestresha.
- q) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit konstruksion metalik nr. 507 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 28.00 €/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Naser Haliti.
- r) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e llojit konstruksion metalik nr. 288 dhe 289 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 56.00 €/muaj për një muaj për parashtruesin e kërkesës Esat Azemi.

II. Para lidhjes së marrëdhënies kontraktuale Qiramarrësit janë të detyruar të paguajnë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, ashtu që për periudhën retroaktive parashtruesit e kërkesave para nënshkrimit të kontratave të qirasë do të duhet të paguajnë shumat si në vijim:

- a) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nga materiali i vrazhdë nr. 12/A – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Xhemajl Radosta duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 6 muajt e kaluar (Tetor 2024 – Mars 2025) shumën prej 858€ – respektivisht (143€/muaj × 6 muaj).
- b) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nga materiali i vrazhdë nr. 189 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Baftir Mustafa duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Mars 2025 – Mars 2025) shumën prej 119€ – respektivisht (119€/muaj × 1 muaj).
- c) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nga materiali i vrazhdë nr. 470 dhe 471 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Fatmir Azemi duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 2 muajt e kaluar (Shkurt 2025 – Mars 2025) shumën prej 258€ – respektivisht (129€/muaj × 2 muaj).
- d) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr. 96 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtrueses së kërkesës Sofije Maloku duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 6 muajt e kaluar (Tetor 2024 – Mars 2025) shumën prej 336€ – respektivisht (56€/muaj × 6 muaj).
- e) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr. 740 dhe 741 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Bedri Rudari duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 6 muajt e kaluar (Tetor 2024 – Mars 2025) shumën prej 336€ – respektivisht (56€/muaj × 6 muaj).
- f) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nga materiali i vrazhdë nr. 29A – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Olti Imeri duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 7 muajt e kaluar (Shtator 2024 – Mars 2025) shumën prej 693€ – respektivisht (99€/muaj × 7 muaj).
- g) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nga materiali i vrazhdë nr. xx – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Imer Imeri (ADI 2007) duhet të paguajë



- retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 7 muajt e kaluar (Shtator 2024 – Mars 2025) shumë prej 3059€ – respektivisht ($437€/muaj \times 7 muajt$).
- h) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo nga materiali i vrazhdë nr. 30A – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Hamdi Imeri duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 7 muajt e kaluar (Shtator 2024 – Mars 2025) shumë prej 693€ – respektivisht ($99€/muaj \times 7 muajt$).
- i) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr. 649 dhe 650 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Xhemajl Radosta duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 6 muajt e kaluar (Tetor 2024 – Mars 2025) shumë prej 336€ – respektivisht ($56€/muaj \times 6 muajt$).
- j) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr. 101–103, 128–130 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Afrim Sylja duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 6 muajt e kaluar (Tetor 2024 – Mars 2025) shumë prej 1002€ – respektivisht ($167€/muaj \times 6 muajt$).
- k) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr. 493 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Qamil Lalloshi duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 2 muajt e kaluar (Shkurt 2025 – Mars 2025) shumë prej 54€ – respektivisht ($27€/muaj \times 2 muajt$).
- l) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr. 494 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Arton Fazliu duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 2 muajt e kaluar (Shkurt 2025 – Mars 2025) shumë prej 54€ – respektivisht ($27€/muaj \times 2 muajt$).
- m) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr. 63 dhe 66 dhe 67 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Naim Berisha duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Mars 2025 – Mars 2025) shumë prej 83€ – respektivisht ($83€/muaj \times 1 muajt$).
- n) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr. 14/A1 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Valon Beqiri duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Mars 2025 – Mars 2025) shumë prej 119€ – respektivisht ($119€/muaj \times 1 muajt$).
- o) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr. 272–274, 364, 365 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Skender Pireva duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Mars 2025 – Mars 2025) shumë prej 139€ – respektivisht ($139€/muaj \times 1 muajt$).
- p) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr. 405 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Bekim Prestresha duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Mars 2025 – Mars 2025) shumë prej 28€ – respektivisht ($28€/muaj \times 1 muajt$).
- q) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr. 507 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Naser Haliti duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 1 muajt e kaluar (Mars 2025 – Mars 2025) shumë prej 28€ – respektivisht ($28€/muaj \times 1 muajt$).
- r) Tokë afariste në të cilën është e vendosur depo e konstruksionit metalik nr. 288 dhe 289 – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesi i kërkesës Esat Azemi duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 6 muajt e kaluar (Tetor 2024 – Mars 2025) shumë prej 336€ – respektivisht ($56€/muaj \times 6 muajt$).

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.



ARSYETIM

Boria sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi. duke u bazuar në faktet si në vijim

Veprimtaria e NSh Tregu konsiston në menaxhimin e tregjeve dhe inkasimin e të hyrave nga qiradhënia e mjediseve biznesore në hapësirat e Tregut. Ndërmarrja Tregu (në likuidim) menaxhon 3 tregjet e qytetit të Prishtinës:

1. Tregu i Gjellbër
2. Tregu në Ulpianë
3. Tregu në Zonën e vjetër Industriale në Prishtinë

Në fokus të këtij raporti është Tregu me Shumicë në Zonën Industriale të Prishtinës, i cili, bazuar në të dhënat e Certifikatës së Pronësisë të gjeneruar nga sistemi digjital i AKK-së, figuron i regjistruar në emër të P.SH. "Fabrika e Amortizatorëve", për ngastrën P-71914059-01560-13 me sipërfaqe 64,830 m², ndërsa disa ngastra kufitare janë të regjistruara në emër të institucioneve të tjera publike ose nuk kanë të dhëna të plota.

Në përputhje me dokumentacionin ekzistues, është identifikuar një mospërputhje midis ngastrës kadastrale nr. 1559/14, e cila ishte përcaktuar me vendim të Komunës për dislokimin e tregut të gjellbër, dhe lokacionit aktual të shfrytëzuar nga ndërmarrja "Tregu". Sipas të dhënave të AKK-së, kjo ngastër figuron në emër të P.SH. Instituti për Hulumtime Shkencore në Bujqësi.

Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar 17 kërkesa zyrtare nga aplikues të ndryshëm, të cilët kanë kërkuar qiradhënien direkte të hapësirave afariste (toka) për qëllime magazinimi (depo) në këtë zonë.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtuesit e këtyre kërkesave, tanimë edhe shfrytëzuesit e këtyre hapësirave do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Prona sipas dokumentacionit të poseduar nga AKP, ZR Prishtinë, dhe sipas listës së aseteve, është tokë afariste përkatësisht treg.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DE 376/2024 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë për asetet të cilat nuk kanë mundur ti sigurojnë herën e parë e vendim të DE 349/2024, prandaj bazuar në informatat e siguruar, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren janë matur asetet dhe çmimi i hapësirave të ofruar me qira.

Kësisoj, Autoriteti i Likuidimit konsideron që është e arsyeshme dhe legjitime që në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, si periudhë të shfrytëzimit do të marrë periudhën nga data kur secili ka hyrë në shfrytëzim të këtyre hapësirave. Andaj, nga palët do të kërkohej që para nënshkrimit të kontratës të paguajnë shumën e qirasë në mënyrë retroaktive nga datat e poshtëshënuara për secilin prej tyre.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 mars 2025





Nr. Ref. BD-221/15

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 2.5 të Kontratës së Qirasë me nr. protokollit 647/2015 në mes të NSH "Urata" dhe qiramarrësit Inter-Trans, dhe nenit 127 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për transferim të Kontratës së Qirasë për shfrytëzimin e zyrave me sipërfaqe prej 45 m² në Komunën e Graçanicës, me qira mujore prej 122.07 € për pronën e NSH "Urata" nga Inter-Trans tek Ljubinko Pavic.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratës të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi duke u bazuar në faktet si në vijim.

Ndërmarrja Shoqërore NSH "Urata" (në likuidim) ka filluar likuidimin me datën 22.08.2007.

Kontrata e qirasë e cila është subjekt transferimi është kontrata e lidhur për herë të parë më datën 29.01.2015, me nr. protokollit 647/2015, dhe objekt i kësaj kontrate të qiradhënies është aseti pronë e NSH "Urata" PRN103, e përbërë nga zyrat në Graçanicë me sipërfaqe prej 45 m².

Sipas kërkesës së qiramarrësit qëllimi i këtij transferimi të kësaj kontrate është për shkak se Inter-Trans është një kompani që nuk është e regjistruar aktualisht në Republikën e Kosovës, prandaj për t'ju shmangur çdo problemi që do të mund të paraqitej, përfaqësuesi i kësaj kompanie ka vendosur që kontratën e qirasë ta bart në emër të vet si person fizik.

Këto zyre kanë hyrë në qiradhënie përmes qiradhënies së bartur.

Më 03.03.2025 ZR Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokollit 26213/2025 të nënshkruar nga personi fizik Ljubinko Pavic i lindur me 07.07.1975 në fshatin Slivov i cili është përfaqësues i Kompanisë Inter-Trans, dhe po kërkon që Kontrata e qirasë të kalojë në emër të tij në mënyrë që në të ardhmen mos t'i paraqitet ndonjë pengesë në lidhje me qiranë. Parashtruesi i kërkesës është i gatshëm të vazhdojë qiramarrjen dhe paguaj qiranë me rregull në emër të tij personal Pavic Ljubinko.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se z.Ljubinko Pavic ka deklaruar se rregullisht do të shlyej të gjitha obligimet nga qiraja edhe pse edhe deri më sot ka qenë gjithherë i rregullt në pagesën e qirasë. Kjo kontratë që nga koha e lidhjes kanë vazhduar pa ndërprerje deri më sot, si dhe qiramarrësi ka qenë i rregullt me pagesa.


Ky aset është në listën e aseteve të propozuara për fondin sovran dhe nuk është ofertuar ndonjëherë për shitje përmes tenderit publik.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 mars 2025





Nr. Ref. BD-221/16

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, nenet 3, 9.5 dhe 9.6 i Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për ndryshim të vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-219/18 të datës 27 shkurt 2025, ashtu që pika I e dispozitivit nën par. IV dhe pika II e dispozitivit nën par. 4 ndryshohen, dhe aprovohet kërkesa për qiradhënie direkte dhe lidhet kontrata e qirasë për tezga nr.102, 103, 104 me sipërfaqe prej 6 m² me çmimin prej 117.00 Euro/muaj për asetin e NSh Tregu.
- II. Qiramarrësi do të jetë i obliguar të paguajë shumën prej 936.00 Euro për periudhën retroaktive nga data 01 gusht 2024 deri më datë 01 mars 2025.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Boria sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e kërkesës së palës për ndryshim të vendimit të Bordit sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Veprimtaria e NSh Tregu konsiston në menaxhimin e tregjeve dhe inkasimin e të hyrave nga qiradhënia e mjediseve biznesore në hapësirat e Tregut. Ndërmarrja Tregu (në likuidim) menaxhon 3 tregjet e qytetit të Prishtinës:

1. Tregu i Gjellbër
2. Tregu në Ulpianë
3. Tregu në Zonën e vjetër Industriale në Prishtinë

Më datë 14 mars 2025, Autoriteti i Likuidimit ka pranuar kërkesë nga Shaqir Shillova duke kërkuar që të shqyrtohet vendimi për nënshkrimin e kontratës së qirasë për stendat 102, 103 dhe 104, të cilat janë llogaritur me 9 metra katrorë. Përveç kësaj, ai thekson se në shfrytëzim ka gjashtë metra katrorë për 2 m² për çdo stendë, plus rrugën që është përdorur gjithmonë për tërheqjen e mallrave në stendë.

Agjencia pas daljes së zyrtarëve në teren ka konfirmuar se pala shfrytëzon 6m² (bazuar që edhe një stendë është rreth 2m² që në total i ka 3 stenda numër 102,103 dhe 104) dhe jo 9 m² sikurse ishte paraqitur në vendimin e BD Nr.Ref BD-219/18. Rrjedhimisht është dashur të bëhet edhe ndryshimi i çmimit të qirasë.

Duke qenë se aset i ka ndërrim të m² është paraqitur propozimi nga ana e AL-së që të bëhet ndryshimi i m² dhe rrjedhimisht edhe Bordi i Drejtorëve të AKP-së kishte nxjerrë vendim me Nr. Ref. BD-219/18 të datës 27 shkurt 2025, ku kishte aprovuar propozimin e Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të Tokës afariste në të cilën është e vendosur tezga/stenda nr.102,103 dhe nr.104 me konstruksion metalik me një sipërfaqe të përgjithshme prej 9.00m² në shumën prej 175.00 Euro për një muaj.

Ndryshimi i vendimit të Bordit të Drejtorëve në lidhje me kërkesën e parashtruesit do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore, dhe paraqet kështu gjendjen faktike dhe nuk do të dëmtojte asnjë palë në këtë proces.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 mars 2025





Nr. Ref. BD-221/17

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, nenet 3, 9.5 dhe 9.6 i Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa për ndryshim të vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-206/96 të datës 30 korrik 2024 në raport me pikën I dhe II të dispozitivit të vendimit të Bordit të Drejtorëve, saktësisht paragrafin i) në dy pikat e dispozitivit të këtij vendimi, si vijon:

j) Kioska nr.13 me sipërfaqe 18.60 m² – Tregu i Ulpianës (ish Amortizatorët) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë nga vlera e tregut të përcaktuar prej 191.00 € për një muaj për parashtruesin e kërkesës Fehmi Hoxha.

II. Para lidhjes së kontratës Qiramarrësit janë të detyruar të paguajnë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Shfrytëzuesit e Paligjshëm për të gjithë periudhën kohore të retrospektivës përkatëse të shfrytëzimit pa kontratë të qirasë si dhe të jenë të detyruar të paguajnë shumën si në vijim:

j) Kioska nr.13 me sipërfaqe prej 18.60 m² parashtruesi i kërkesës Fehmi Hoxha do të duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzimin pa kontratë të qirasë që nga data 01 gusht 2024 deri më 31 mars 2025 shumën prej 1,528.00€.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Boria sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e kërkesës së palës për ndryshim të vendimit të Bordit sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Veprimtaria e NSh Tregu konsiston në menaxhimin e tregjeve dhe inkasimin e të hyrave nga qiradhënia e mjediseve biznesore në hapësirat e Tregut. Ndërmarrja Tregu (në likuidim) menaxhon 3 tregjet e qytetit të Prishtinës:

1. Tregu i Gjellbër
2. Tregu në Ulpianë
3. Tregu në Zonën e vjetër Industriale në Prishtinë

Gjatë përgatitjes së raportit të vlerësimit ishin kryer matjet nga ana e komisionit dhe ishte konstatuar se kioska nr.13 me sipërfaqe 18.60m² - Tregu i Gjellbër (te Ulpiana) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 277.00 € për një muaj për parashtruesin e kërkesës Fehmi Hoxha.

Bordi i Drejtorëve kishte shqyrtuar kërkesat e paraqitura dhe të njëjtat i kishte aprovuar me vendimin Nr.Ref. BD-208/85 të datës 29 gusht 2024.

Me datë 18.09.2024, Autoriteti i Likuidimit i kishte dërguar shkresës palës ku e kishte informuar në lidhje me vendimin e Bordit të Drejtorëve dhe kishte kërkuar që të paraqitet për nënshkrim të kontratës së qirasë.

Pas kësaj, pala është përgjigjur më datë 18.09.2024 duke paraqitur ankesat në lidhje me çmimin dhe për vendimin e Bordit të Drejtorëve (referencë BD-208/85) që përcakton çmimin e qirasë për kioskën nr. 13 në Tregun e Gjellbër në lagjen Ulpiana, Prishtinë.



Sipas vlerësimit të AL-së, dhe pas raportit të komisionit vlerësues përmes të cilit është bërë ri-vlerësimi i qirasë pas ankesës së parashtruesit të kërkesës duke u bazuar që çmimi dallon dukshëm nga shfrytëzuesit tjerë të së njëjtës kategori të asetit dhe zonës. Andaj, konsiderojmë se është e arsyeshme që të ndryshohet vendimi i Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-208/85 të datës 29 Gusht 2024 në raport me sipërfaqen dhe çmimin e përcaktuar dhe kështu të bëhet e mundur lidhja e kësaj kontrate.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DE 317/2024 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit të qiranë, bazuar në informatat në bazë të matjeve në terren sipërfaqja e brendshme prej 18.60 m² është përcaktuar vlera e çmimit prej 10.28 Euro/m².

Kështu, Autoriteti i Likuidimit konsideron që është e arsyeshme dhe legjitime që në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, si periudhë të shfrytëzimit do të marrë periudhën nga data kur secili ka hyrë në shfrytëzim të këtyre hapësirave. Andaj, nga palët do të kërkohej që para nënshkrimit të kontratës të paguajnë shumën e qirasë në mënyrë retroaktive nga datat e poshtë shënuara për secilin prej tyre.

Kjo hapësirë nuk është në listën e aseteve të cilat janë propozuar Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me strategjinë për krijimin e Fondit Sovran. Më parë këto hapësira nuk janë tenderuar ndonjëherë për qiradhënie përmes tenderit publik.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 mars 2025





Nr. Ref. BD-221/18

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Nenit 10. 1.5 i Rregullores Nr. Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa\ për qiradhënie direkte të ngastrës kadastrale P-04223-2 ZK Gjakovë Jashtë Qytet me sipërfaqe totale prej 1109 m² pronë e NSh "Emin Duraku" për parashtruesin e kërkesës Xhevat Zenelaj, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 155.00 Eur/muaj.
- II. Para lidhjes së marrëdhënies kontraktuale Qiramarrësit janë të detyruar të paguajnë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, ashtu që për periudhën retroaktive, duke e llogaritur nga tetori 2024 deri në mars 2025, koha nga kur kanë filluar është identifikuar shfrytëzimi. Për shfrytëzimin e kësaj hapësire qiramarrësit do të i kërkohej të paguajë retroaktivisht shumën prej 930.00 €.

III. Ky vendim lyp në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi duke u bazuar në faktet si në vijim .

NSh "Emin Duraku" PEJ110 është në proces të likuidimit që nga data 02 shtator 2013.

Më datë 24.10.2024 është pranuar kërkesa nga ana e Xhevat Zenelaj për qiramarrjen e pjesës së ngastrës kadastrale P-04223-2 ZK Gjakovë, në sipërfaqe prej 1109 m².

Pala e njëjtë është qiramarrës i ngastrës 04223-1 ZK Gjakovë Jashtë Qytet nga 12.06.2023 përmes tenderit publik për qiradhënie dhe i njëjti ka filluar me shfrytëzimin e kësaj ngastre pas parashtrimit të kërkesës për qiramarrje.

Ky fakt konstatohet nga ana e raporteve të vizitës në terren, ku në bazë të raportit të vizitës në terren të datës 23.09.2024 nuk kishte ndryshime në këto dy parcela dhe parcela 04223-2 nuk ishte duke u shfrytëzuar.

Pas parashtrimit të kërkesës dhe raportit të vizitës në terren që ishte kryer, ishte konstatuar se pala kishte filluar me shfrytëzimin e parcelës 04223-2, ashtu që kishte larguar rrethojat dhe kishte filluar ta shtojë me zhavor një pjesë të kësaj ngastre, ashtu që të i mundësohet qasje tek parcela që e ka me qira edhe përmes kësaj parcele.

Sipërfaqja totale e parcelës në bazë të certifikatës së pronësisë është 2358 m² ku në disa pjesë të parcelës ka ndërtime ilegale dhe një pjesë është rrugë dhe pjese e shfrytëzueshme sipas matjeve nga ana e Komisionit është prej 1109 m².

Pala e arsyeton kërkesën e tij mbi bazën që shfrytëzimi i këtij aseti është bërë për arsye se qasja në parcelën që tanimë e ka me qira është më e lehtë përmes kësaj ngastre.

Autoriteti i Likuidimit konsideron që pasi që tërë parcela 04223-2 ZK Gjakovë Jashtë Qytet nuk mund të lëshohet me qira për shkak të gjendjes faktike dhe duke qenë se është ngjitur me parcelën të cilën e ka pala me qira dhe pasi që pretendon të drejtën e parablerjes përmes negocimit direkt atëherë vlerësojmë se qiradhënia në këtë rast është e arsyeshme.



Komisioni i formuar në bazë të vendimit DE 619-2025 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruar, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për ngastrën kadastrale P-04223-2 ZK Gjakovë Jashtë Qytet me sipërfaqe prej 1109 m² është në shumën prej 155.00 Euro për një muaj.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSH-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Pala, duke pasur parasysh që edhe kjo pjesë e parcelës është shfrytëzuar nga tetori 2024, atëherë pala do të jetë i obliguar që retroaktivisht të paguajë shumën prej 930 Euro (tetor 2024 – mars 2025).


Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 mars 2025





Nr. Ref. BD-221/19

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Neni 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Neni 10. 1.4 i Rregullores Nr. Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Neni 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të lokalit afarist në Rr. 24 Nëntor lokali Nr 15 i NSH Univerzal në Leposaviq, me sipërfaqe totale prej 61.9 m², sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 141.75 bruto në muaj për palën Rrahim Pacolli.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Boria sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Lokali afarist i cili ndodhet në Rr. 24 Nëntor lokali Nr 16 i NSH Univerzal në Leposaviq është pjesë e ndërtesës afariste-banesore. Sipas listës së aseteve të NSH "Univerzal" MIT051, lokali afarist ka sipërfaqe prej 61.9 m² dhe aktualisht është listuar apo kategorizuar si aset për tu privatizuar nga AKP në valët e ardhshme të shitjes.

Me datë 03.02. 2025, Agjencia ka pranuar shkresën me nr. protokolli 5503/2025, të parashtruar nga z Rrahim Pacolli , përmes së cilës kanë adresuar kërkesën për marrje me qira të këtij lokali afarist dhe lokalit me nr. 15, për nevoja të punonjësve të Bankës Ekonomike të marrë me qira muaj më pare nga AKP. Pala më datë 18.02.2025 së bashku me kërkesën ka sjellë edhe pëlqimin e dhënë nga ana e KK Leposaviq, ku ofrohet mbështetje për marrjen me qira të këtij aseti me qëllim të hapjes së biznesit në këtë lokacion.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 582a/2025 të u.d. Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruara, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për lokalin nr.15 me sipërfaqe prej 61.9 metra katrorë, e cila gjendet në Rr. 24 nëntor pn, Leposaviq është në shumën prej 141/75 Euro/muaj.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së NSH-ve dhe me qëllim të gjenerimit të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme, këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSH-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Ky aset nuk është në listën e aseteve të cilat i janë propozuar Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me strategjinë për krijimin e Fondit Sovran, por është i kategorizuar si aset për tu privatizuar nga AKP në valët e ardhshme të shitjes.

MH



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 mars 2025





Nr. Ref. BD-221/20

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Neni 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në., Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për falje të borxhit në shumën prej 6,904.60 €, e akumuluar nga z. Besim Muzaqi, si pasojë e pamundësisë për përmbushjen e detyrimeve të kontratës së qirasë për shkak të gjendjes së tij të rëndë shëndetësore dhe paaftësisë për punë.
- II. Aprovohet pezullimi i kontratës së qirasë për tokën afariste nr. 58 – NSh Tregu deri në një vendim të mëtejshëm, bazuar në vlerësimin e gjendjes shëndetësore dhe mundësisë për rifillimin e aktivitetit afarist.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Boria sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e kërkesës së palës për ndryshim të vendimit të Bordit sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Veprimtaria e NSh Tregu konsiston në menaxhimin e tregjeve dhe inkasimin e të hyrave nga qiradhënia e mjediseve biznesore në hapësirat e Tregut. Ndërmarrja Tregu (në likuidim) menaxhon 3 tregjet e qytetit të Prishtinës:

1. Tregu i Gjelbër
2. Tregu në Ulpianë
3. Tregu në Zonën e vjetër Industriale në Prishtinë

Me datë 19.02.2025, Zyra Rajonale e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në Prishtinë ka pranuar shkresën/deklaratën me nr. protokolli 26188/2025, të parashtruar nga z. Besim Muzaqi, me të cilën ai ka kërkuar të lirohet nga detyrimet e derivuara nga kontrata e qirasë për tokën afariste nr. 58 dhe pezullimin e kontratës, bazuar në rrethanat e jashtëzakonshme shëndetësore dhe pamundësinë për të ushtruar veprimtarinë afariste që ka rezultuar si pasojë e pamundësisë së tij për të kryer pagesat e qirasë për pronën e shfrytëzuar. Si arsye kryesore për këtë kërkesë, z. Muzaqi ka deklaruar se ai po përballët me një sëmundje të rëndë tumorale – karcinoma planocelulare e laringut (C32.8) – e cila e ka penguar të ushtrojë aktivitetin e tij afarist për një kohë të gjatë dhe e ka detyruar të fokusohet në trajtimin shëndetësor të domosdoshëm.

Kërkesa e palës është mbështetur me dokumentacion të detajuar mjekësor, duke përfshirë raporte mjekësore nga institucionet shëndetësore, faturat e trajtimit onkologjik, dokumentacionin që dëshmon shpenzimet për kimioterapi dhe radioterapi, si dhe dëshminë e paaftësisë për punë dhe përfitimit të pensionit për paaftësi të përhershme.

Gjendja e tij shëndetësore është e rëndë dhe trajtimi i tij vazhdon të jetë i domosdoshëm, ndërsa barra financiare e akumuluar e ka vështirësuar edhe më tej gjendjen e tij dhe të familjes së tij. Për shkak të sëmundjes, ai është i paaftë për të punuar dhe për të siguruar të ardhura për familjen e tij, ndërkohë që është mbajtur i familjes dhe çdo barrë financiare shtesë rrezikon jo vetëm shëndetin e tij, por edhe mirëqenien e anëtarëve të familjes së tij.



Bordi konsideron se falja e borxhit nuk është vetëm një çështje financiare, por një domosdoshmëri humane për një person që ka dhënë kontributin e tij në aktivitetin afarist dhe që tani po përballet me një situatë të jashtëzakonshme që e ka pamundësuar funksionimin e tij ekonomik dhe ka sjellur familjen në gjendje të vështirë ekonomike.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 mars 2025





Nr. Ref. BD-221/21

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), bazuar në dosjen e tenderit dhe në neni 14.1 të kontratës me numër identifikues 239-18-9399-2-1-1 respektivisht të Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK) ashtu siç specifikohet në nenin 6 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK), paragrafi 3.33 i dosjes së tenderit të kontratës), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 27 mars 2025, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Bordi i Drejtorëve të Agjencisë aprovon Raportin përfundimtar të kontraktorit për periudhën 1 korrik 2024 - 31 dhjetor 2024.
- II. Autorizohet Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve, Drejtori Ekzekutiv dhe Udhëheqësi i Divizionit të Likuidimit dhe Autoritetit të Likuidimit që të nënshkruajnë Certifikatën për Përmbylljen e Detyrimeve Kontraktuale të paraparë në nenin 14.1 të Kushteve të Veçanta të Kontratës ndërmjet AKP-së dhe konsorciumit "Curtis, Mallet-Prevost, Colt & Mosle" LLP, "Grant Thornton Consulting" Doo dhe "Grant Thornton" L.L.C.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Komitetit Drejtues të Likuidimit për aprovimin e raportit 5 (pesë) vjeçar për kontratën e likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore dhe autorizimi për Kryesuesin e Bordit të Drejtorëve për Lëshimin e Certifikatës së Kompletimit

Ky vendim është aprovuar duke pas parasysh faktet si në vijim:

Në dhjetor 2018 AKP-ja kishte shpallur tender publik ndërkombëtar për angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve Profesionale (OSHP) për Likuidimin e portofolios së Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë. Kontrata me numër identifikues 239-18-9399-2-1-1 ishte nënshkruar me datë 28 qershor 2019 në mes të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe kontraktorit/konsorciumit "Curtis, Mallet-Prevost, Colt & Mosle" LLP, "Grant Thornton Consulting" Doo dhe "Grant Thornton" L.L.C. për Ofrues të Shërbimeve Profesionale në projektin e likuidimit të portofolios së Ndërmarrjeve Shoqërore në territorin e Republikës së Kosovës për periudhën 5 (pesë) vjeçare nga data 1 korrik 2024 deri më 30 qershor 2024.

Me datë 1 korrik 2024 ishte nënshkruar aneks kontrata me numër identifikues 239-124-5024-2-1-5/C209. Kohëzgjatja e kësaj aneks kontrate ishte 6 (gjashtë) muaj duke filluar nga 1 korrik 2024 për të përfunduar me 31 dhjetor 2024. Deri në përfundimin e kësaj aneks kontrate për 595 NSH kishin filluar procedurat e Likuidimit.

Menaxheri i Projektit ka përgatitur një raport të bashkangjitur këtij memorandumit duke përfshirë aspektet kryesore të projektit të Likuidimit:

- Vendosja në procedurë të likuidimit dhe emërimi i Autoriteteve të Likuidimit për 6 NSH;
- Shqyrtimi i kërkesave kreditore dhe lëshimi i vendimeve nga AL-të, 70 vendime të AL-ve;
- Numri i NSH-ve për të cilat është përmbyllur procesi i likuidimit - 3 NSH të mbyllura nga kontraktori;
- Raportet vjetore të kontraktorit (raporti vjetor i OSHP-së dhe raporti vjetor i likuidimit të NSH-ve) për periudhën nga 1 korrik 2024 deri më 31 dhjetor 2024;



- Raporte të Përkohshme, Raporte të Përkohshme dhe të Pjesshme, Raporte shtesë të Përkohshme dhe Raporte të korigjuara të Përkohshme;
- Raportet për heqje dorë të aseteve të dorëzuara në Bordin e Drejtorëve dhe në DhPGJSK;
- Pasqyrimi i pagesave ndaj kontraktorit;
- Sfidat me të cilat është përballur OShP-ja në procesin e likuidimit nga 1 korrik 2024 deri më 31 dhjetor 2024.

Komiteti Drejtues i Likuidimit (KDL) me datë 19 mars 2025 ka mbajtur mbledhje dhe ka shqyrtuar raportin përfundimtar të kontraktorit për periudhën 1 korrik 2024 - 31 dhjetor 2024.

Vështirësitë dhe pengesat kryesore gjatë zbatimit të kontratës:

Duhet theksuar se OShP nuk ishte në gjendje që të përmbush të gjitha objektivat kontraktuale për arsye si në vijim:

1. *Trajtimi i aseteve jashtë vendit:*

- Pamundësia për të shitur ose hequr dorë nga asete të caktuara jashtë vendit për arsye të ndryshme, si p.sh., vendimet e autoriteteve publike të vendit ku ndodhen asetet, çështjet që kanë të bëjnë me uzurpimin e këtyre aseteve, vështirësitë në qasjen në objektet e aseteve që ndodhen jashtë vendit, mund të jenë pengesë e madhe për përfundimin sa më efikas të procesit të likuidimit.

2. *Shpronësimet e aseteve:*

- AL-të janë në dijeni që shpronësimet e aseteve në Kosovë nuk trajtohen nga AKP-ja, por nga organet e tjera administrative. Prandaj, AL-të nuk kanë kontroll mbi mënyrën se si adresohen këto çështje. Për hir të një procesi sa më efikas dhe në kohë të likuidimit, është e rëndësishme që procedurat e shpronësimit dhe çdo çështje dhe pretendim i mundshëm i tyre të trajtohen me kohë nga autoritetet kompetente administrative.

3. *Çështjet kadastrale:*

- Një pengesë tjetër për shitjen efikase të aseteve të NSh-ve janë çështje të caktuara kadastrale, që kryesisht vijnë nga mungesa e të dhënave kadastrale dhe mundësia për të marrë të dhëna të tilla nga shtetet fqinje. Ndër pasojat e mundshme të këtyre çështjeve janë vështirësitë në përcaktimin e pronarit aktual të një ngastre të tokës dhe/ose kufijve aktualë të pasurisë së tillë. Këto pengesa, mund të kenë ndikim negativ në përshpejtimin e procesit të likuidimit, pasi, pa u zgjidhur çështjet e tilla, është e vështirë që AL-të të aprovonë shitjen/heqjen dorë të aseteve në fjalë.

4. *Informatat dhe dokumentet nga DhPGJSK:*

- Para mbylljes së likuidimit të NSh-së, nga DhPGJSK-ja kërkohet konfirmimi se nuk ka lëndë të pazgjidhura në lidhje me NSh-në në fjalë. Mungesa e informacioneve rreth gjendjes së lëndëve të pazgjidhura mund të shkaktojë vonesa të mundshme.

5. *Vendimet në pritje pranë Gjykatave Themelore:*

- OShP-ja është informuar se disa lëndë në lidhje me qiratë e papaguara dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme në favor të AL-ve aktualisht janë në pritje përpara Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës. Mundësia e rasteve të tilla që marrin disa vite për t'u vendosur mund të përbëjë pengesë për mbylljen e likuidimit, veçanërisht të atyre likuidimeve, kur kërkesat e aprovuara të kreditorëve nuk mund të përmbushen plotësisht. Sidoqoftë, sa herë që fondet e likuidimit janë të mjaftueshme për të përmbushur plotësisht kërkesat e aprovuara të kreditorëve, fondet tepriçë do t'i shpërndahen Qeverisë.

6. *Vonesat në marrjen e informacioneve nga DhPGJSK-ja:*

- OShP-ja, gjatë periudhës nga 1 korrik 2024 deri më 31 dhjetor 2024, është ballafaquar me disa vonesa të konsiderueshme në marrjen e informacioneve nga DhPGJSK-ja. Kjo rrethanë është një faktor i jashtëm që ka ngadalësuar aktivitetet e grumbullimit dhe përpunimit të dokumenteve dhe informacioneve të nevojshme për vlerësimin e kërkesave dhe analizën e



Me anë të lëshimit të Certifikatës për Përbushjen e Detyrimeve Kontraktuale lirohet edhe depozita e sigurimit të performancës së kontratës. Kjo certifikatë lëshohet duke u bazuar në nenin 14.1 të kontratës me numër identifikues 239-18-9399-2-1-1 respektivisht të Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK) ashtu siç specifikohet në nenin 6 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK), si dhe për aprovimin e raportit 6 (gjashtë) mujor: paragrafi 3.33 i dosjes së tenderit të kontratës

Duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 mars 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordit Drejtoreve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-221/22

Në bazë të neneve 5.1.1.2 dhe 15.2.17 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas diskutimeve sipas rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e statusit të ndërmarrjeve të caktuara (KPS), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Raporti Shqyrtues i Komisionit për Shqyrtimin e KPS-ve, lidhur me përcaktimin e statusit të: Njesisë Punuese "Bar Bilje" – aset në Zubin Potok/Kosovë - KPS 0824/MIT052 sipas së cilit konstatohet se Njësia Punuese "Bar Bilje" – aset në Zubin Potok/Kosovë si dhe çdo aset i ndërmarrjes që do të identifikohet në të ardhmen, janë në pronësi shoqërore dhe bien nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave për Përcaktimin e Statusit të Entiteteve (KPS), ku sipas tij bazuar në nenin 5.1.1.2, të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 04/L034, si dhe dëshmive të dokumentuara në dosjet e lëndëve të lartcekura në të cilat është dëshmuar se se Njësia Punuese "Bar Bilje" Aseti në Zubin Potok/Kosovë – KPS 0824/MIT052, si dhe çdo aset tjetër i ndërmarrjes që do të identifikohet në të ardhmen janë pronësi shoqërore dhe bien nën juridiksionin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 mars 2025.

